



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR

Nr. 1615/4 Prot

Shkodër, me dt. 26.10.2023

NJOFTIM

L ë n d a: Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për lëvizje paralele në kategorinë drejtuese, pozicioni “Shef Sektori, në Sektorin e Protokollit Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit”.

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

KËSHILLIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 “Për Organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Vendimit nr. nr.622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Shkresës nr. 1613 prot, datë 10.10.2023, për shpalljen e procedurës së lëvizjes paralele dhe të pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë drejtuese, për pozicionin: **1 (një) pozicion – “Shef Sektori, në Sektorin e Protokollit Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit”**, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kategoria e ulët drejtuese III-2:

Konstatohet se në përfundim të afatit (datë 24.10.2023), në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë drejtuese në pozicionin “**Shef Sektori, në Sektorin e Protokollit Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit**” pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kategoria e ulët drejtuese III-2, janë paraqitur një kandidaturë e cila i plotëson kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta dhe të përgjithshme si më poshtë:

1. Mimoza Ndoci

Në këto rrethana bazuar në nenin 9 dhe 11 të Vendimit nr.622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” dhe kreut II, pika “5” të Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e

plotësimi të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së **lëvizjes paralele**, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” procedura për ngritje në detyrë në shërbimin civil gjyqësor do të vazhdoj me vleresimin profesional i cili **do të zhvillohet në përputhje me pikën 7 të këtij udhëzimi** në ambjentet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër .

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KANCELARE

Valbona SULEJMANI

